

21.04.2025

TERMAT E REFERENCES

RADIO LOKALE PËR REALIZIMIN E DEBATEVE PËR PROJEKTET TË IMPLEMETUARA NGA OJQ “NEVO KONCEPTI”

Të dhënat mbi OJQ “Nevo Koncepti” dhe kërkesat për shërbimet nga kompanit.

Organizata	OJQ “NEVO KONCEPTI”
Objektiva	Ofrimi i shërbimeve për realizimin e debateve ne radio lokale.

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 4 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Radioja e përzgjedhur do të jetë përgjegjëse për realizimin dhe transmetimin e përmbajtjes mediatike në përputhje me objektivat e projekteve. Më konkretisht, ajo do të angazhohet për këto detyra:

- Transmetimi i spot-eve me gjatësi 30-60 sekonda në orare të përshtatshme për audiencën e synuar.
- Realizimi dhe Transmetimi i Emisioneve informuese.
- Promovimi Online (sipas marrëveshjes).
- Bashkëpunimi me Organizatorin e Projektit.
- Raportimi dhe Dokumentimi.

3. AFATI KOHOR

Angazhimi i kompanisë radiofonike do të realizohet në kuadër të aktiviteteve të projekteve dhe do të përfshijë një periudhë të caktuar për përgaditjen dhe transmetimin e përmbajtjes mediatike, si dhe raportimin përkatës. Kohëzgjatja e angazhimit pritet të jetë nga data 01.05.2025 deri më 31.12.2025, varësisht sipas projekteve të cilat kanë të planifikuara radio debate ose promovime të aktiviteteve.

4. REZULTATET E PRITSHME

- Bashkëpunim të mire në mes OJQ-s dhe kompanisë përfituese.
- Përgjigjja në kohë me dokumentacione përcjellëse pas blerjes si fatura.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen duke përfshirë këto dokumente:

- Çertifikata e Biznesit
- Dy (2) referencë.
- Dokument i cili dëshmon që aplikuesi/ja nuk është nën hetime.
- Oferten Financiare

Aplikimi duhet të dërgohet **jo** më larg se data **30.04.2025** në emailin zyrtarë të Organizatës Nevo Koncepti prokurimi@nevokoncepti.org apo në formë fizike në selin e OJQ''Nevo Koncepti'' Rr.Adnan Krasniqi hyrja II nr.8 Prizren.